Njoftim për përqendrim me të cilin ARIKOMA a.s., Republika Çeke, do të fitojë kontrollin mbi KOSTAKS spol. s.r.o., Republika Çeke
(Lënda nr. 08-146/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 13.10.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin ARIKOMA a.s., me seli të regjistruar në Vinohradska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, do të fitojë kontrollin e vetëm mbi KOSTAKS spol. s.r.o., me seli të regjistruar në V. Nezvala 745/22, Çeshki Budejovice 5, 370 06 Çeshki Budejovice, Republika Çeke, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste

ARIKOMA a.s. është shoqëri holding që administron me pjesët në shoqëritë e saj të varura, të cilat veprojnë në industrinë e teknologjisë së informacionit. ARIKOMA a.s. është pjesë e Grupit KKCG. Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikën, pasuritë e paluajtshme dhe teknologjinë e informacionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e operimit me terminale të videolotarisë dhe në tregun e teknologjisë së informacionit, nëpërmjet shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAKEDONIJA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare – veprimtari të lojërave të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë – KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare – veprimtari të lojërave të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për teknologji të informacionit AVENGA SHPKNJP Shkup, me veprimtari prioritare – programim kompjuterik; dhe
- Shoqëria për arsimim kompjuterik dhe zhvillimin e inovacioneve AVENGA Akademi SHPKNJP Shkup, me veprimtari prioritare – arsimim tjetër i paklasifikuar diku tjetër.

Veprimtaria kryesore e KOSTAKS spol. s.r.o. përfshin shitjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve harduerike, përfshirë serverët, virtualizimin e pajisjeve harduerike, ndërtimin e rrjeteve kompjuterike me kabllo dhe pa kabllo, sigurinë e teknologjisë së informacionit, si dhe ndërtimin e sistemeve të kabllove të strukturuara, përfshirë kabllot optike.

Përveç kësaj, KOSTAX spol s.r.o ofron shërbime telekomunikacioni, sisteme CCTV dhe sisteme të tjera sigurie/tension të ulët, së bashku me mbështetje dhe mirëmbajtje të vazhdueshme teknike. Në përgjithësi, KOSTAX spol s.r.o vepron si një integrues i infrastrukturës dhe sistemeve të IT-së "nga fillimi në fund" për klientët e biznesit dhe të sektorit publik..

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të përkufizohet si treg i shërbimeve të teknologjisë së informacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi..

19.10.2026
Shkup